



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja-Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development*

Duke u bazuar në neni 1.3 pika (d) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 8, paragrafi 8.2 dhe 8.5 Ligjin Nr. 2004/21 për Veterinarinë të datës 30.07.2004, neni 21 paragrafi 21.1 të Ligjit Nr.02/L-111 për Bletari, të dt. 08.02.2008, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.15/2008

Për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të bletëve

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen masat të cilat autoriteti kompetent duhet t'i ndërmerr për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të bletëve si: Pesta Amerikane, Pesta Evropiane, Nozematoza, Varoatoza dhe Akaroza.

Neni 2
Përkufizimet

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ, shprehjet e përdorura kanë këto domethënie:
“**Pesta Amerikane**” është sëmundje infektive e bletëve e cila shkaktohet nga bakterja Bacillus larvae White;
“**Pesta Evropiane**” është sëmundje infektive e bletëve e cila shkaktohet nga bakteret Streptococcus pluton white, Bacillus alvaei, Achromobacter eurydice, Streptococcus faecalis dhe Bacillus laterosporis;
“**Nozematoza**” është sëmundje parazitare e bletëve, e shkaktuar nga protozoa Nosema apis zander;
“**Varoatoza**” është sëmundje parazitare e bletëve, e shkaktuar nga paraziti Varroa jacobson;
“**Akaroza**” është sëmundje parazitare e bletëve, e shkaktuar nga paraziti Acarapis woodi;

“**Bletar**”- person fizik ose juridik i cili merret me kultivimin e bletëve për përfitimin e prodhimeve të bletëve dhe amave të tyre;

“**Bletë**” - nënkupton amat, bletët punëtore dhe brumbujt;

“**Shoqëri bletësh**”- nënkupton bashkësinë e amave, bletëve punëtore dhe brumbujve të vendosura në zgjua;

“**Bletari**”- nënkupton mbarështimin, rritjen, shumëzimin, prodhimin dhe qarkullimin e bletëve të species Apis Mellifera, prodhimeve të bletëve si dhe pajisjet për bletari;

“**Bletore**” – nënkupton vendin ku vendosen zgjojet me bletë, mund të jenë të hapura ose në ndonjë shtëpizë me etazhe, por mund të vendoset edhe në makina për transport;

“**Autoriteti kompetent**”- nënkupton Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës – AVUK;

“**Veterinari i autorizuar**” është veterinari i autorizuar nga Autoritetit kompetent.

Neni 3

3.1 Çdo bletarë me rastin e dyshimit të paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës siç janë: Pesta Amerikane-Pestis Apis, Pesta Evropiane-Pestis Apis, Nozomatoza-Nosemosis, Varoatoza -Varosis, dhe Akaroza- Acarapis, Acarosis, si dhe dëmtimeve të pidentifikuara ose helmimet, obligohet të lajmërojë menjëherë veterinarin e autorizuar dhe autoritetin kompetent.

3.2 Veterinari i Autorizuar së bashku me inspektorin veterinar duhet t’i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve të bletëve në pajtim me Ligjin për Veterinarinë.

Neni 4

Autoriteti kompetent në fillim të çdo viti përcakton masat profilaktike për luftimin e sëmundjeve të bletëve.

Neni 5

5.1 Ndalohet asgjësimi i shoqërive të bletëve përveç në rastet e vërtetimit në mënyrë laboratorike për prezencën e sëmundjeve nga neni 1 i këtij udhëzimi administrativ.

5.2 Asgjësimi bëhet në prezencë të inspektorëve të autorizuar.

Neni 6

Qarkullimi dhe përdorimi i preparateve për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr.2003/26 për Produktet Medicinale dhe Pajisjet Medicinale të dt. 7.07.2004.

Neni 7

7.1 Ndalohet trajtimi me preparate të cilat nuk e kanë lejen për përdorim sipas legjislacionit në fuqi.

7.2 Ndalohet përdorimi i preparateve helmuese dhe materieve të tjera, të cilat përmes produkteve të bletës mund t’a dëmtojnë shëndetin publik.

Neni 8

Gjatë lëvizjes së bletëve, bletari duhet të posedoi çertifikatën e gjendjes shëndetësore dhe çertifikatën e transportit nga autoriteti kompetent.

Neni 9

Pesta Amerikane dhe Pesta Evropiane

Shoqëria e bletëve konsiderohet e infektuar nga Pesta amerikane dhe Pesta evropiane nëse:

- a) me shenjat klinike konstatohet prania e këtyre sëmundjeve;
- b) me metodat diagnostike verifikohet prania e shkaktarëve të sëmundjeve.

Neni 10

10.1. Hulumentit diagnostik i nënshtrohen të gjitha shoqëritë e bletëve në të cilat dyshohet prania në sëmundjet nga neni 1 të këtij udhëzimi administrativ.

10.2. Hulumentimet diagnostike për Pestën Amerikane bëhen në muajin shtator ose tetor në bletoret në të cilat ka qene e konstatuar sëmundja.

Neni 11

Nëse verifikohet se në bletore është e pranishme Pesta amerikane dhe Pesta Evropiane, autoriteti kompetent i ndërmerr këto masa:

- a) urdhëron mbylljen e bletores së infektuar;
- b) urdhëron asgjësimin e koshereve të infektuara së bashku me bletët, ushqimin dhe hojet e tyre. Asgjësimi bëhet me djegëje dhe groposje duke i zbatuar edhe rregullat e dezinfektimit të koshereve dhe pajisjeve të përdorura;
- c) bënë kontrollimin dhe mjekimin e koshereve të forta -shëndosha nëse për këtë lejon situata epizootioplogjike dhe kushtet atmosferike;
- d) ndalon mbajtjen e shoqërive të bletëve pa amë dhe nuk e lejon shumimin e bletëve në bletoren e infektuar.

Neni 12

Në radiusin prej 3 km prej bletores së infektuar është e nevojshme që të bëhet hulumentimi diagnostik për Pestën amerikane dhe Evropiane në të gjitha shoqëritë e bletëve, duke e bërë trajtimin me medikamente, të cilat janë të parapara për preventivën e këtyre sëmundjeve.

Neni 13

13.1 Konstatohet se pesta amerikane ka kaluar nëse janë respektuar të gjitha masat e parapara me nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.

13.2 Në këto bletore duhet të zbatohen kontrollet dhe hulumentimet diagnostike dy muaj pasi janë zbatuar të gjitha masat e parapara.

Neni 14

Nozematoza

Konstatohet se bletët janë të infektuara me Nozematoze– Nosemosis, nëse me:

- a) shenjat klinike konstatohen ndryshimet, si karakteristik e kësaj sëmundje të bletëve

b) me hulumtim diagnostik konstatohet prania e Nosema apis.

Neni 15

Hulumtimi diagnostik për sëmundjen e Nozematozes zbatohet një herë në vit në muajin mars dhe këtij hulumtimi i nënshtrohen të gjitha kosheret në bletore, bletoret të cilat i rrisin - kultivojnë amët, dhe të gjitha bletoret e dyshimta në praninë e Nosema apis.

Neni 16

Në rast se konstatohet prania e Nozematozes, Autoriteti kompetent i ndërmerr këto masa:

- a) mjekimin e shoqërive të bletëve me preparate të regjistruara dhe të lejuara dhe transferimi i shoqërive të mjekuara në koshere të dezinfektuara.
- b) mbylljen e bletarisë së infektuar dhe ndalimin e qarkullimit deri në përfundimin e mjekimit.
- c) dezinfektimin e koshereve hojeve dhe pajisjeve të tjera, të cilat janë përdorur në bletoren e infektuar.

Neni 17

Nëse me hulumtim diagnostik konstatohet prania e shkaktarit të Nosema apis pa shenja klinike, atëherë do të bëhet mjekimi i të gjitha shoqërive të bletëve në atë bletari me preparate të lejuara.

Neni 18

Konstatohet se në bletari ka kaluar Nozematoza nëse janë zbatuar të gjitha masat e parapara në nenin 16 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 19

Varoatoza

Konstatohet se bletët janë të sëmura nga Varoatoza, nëse me shenjat klinike konstatohet prania e kësaj sëmundje dhe nëse me hulumtim diagnostik verifikohet shkaktari Varroa jacobsoni.

Neni 20

20.1 Hulumtimit diagnostik për sëmundjen e Varoatozës zbatohet një herë në vit- në muajin mars dhe këtij hulumtimi i nënshtrohen të gjitha bletoret me shoqëritë e bletëve, bletoret të cilat i rrisin dhe kultivojnë amët, dhe të gjitha bletoret e dyshimta në praninë e Varoatozës.

20.2 Nëse dyshohet se shoqëria e bletëve është e infektuar me këtë sëmundje, hulumtimi diagnostik mund të zbatohet edhe në muajt e tjerë të vitit.

Neni 21

21.1 Në rast se konstatohet prania e sëmundjes së Varoatozës në radius prej 3 km do të zbatohen këto masa:

- a) mjekimi i shoqërive të infektuara më së paku dy herë në vit zakonisht në pranverë dhe vjeshtë;
- b) heqja e brumbujve prej koshereve duke i përdorur metodat për asgjësimin e parazitëve, tërheqja e larvave të brumbujve prej koshereve dhe përdorimi i metodave tjera për zhdukjen e parazitit.

21.2 Nuk lejohet transferimi i bletëve të infektuara deri sa mos të kalojë periudha e trajtimit të tyre.

Neni 22

Konstatohet se Varoatoza ka kaluar pasi janë të zbatuar të gjitha masat nga neni 21 i këtij udhëzimi administrativ.

Neni 23

Akaroza

Konstatohet se bletët janë të sëmura nga Akaroza nëse me shenjat klinike konstatohet prania e kësaj sëmundje dhe nëse me hulumtim diagnostik verifikohet shkaktari *Acarapis woodi*.

Neni 24

Hulumtimi diagnostik për sëmundjen e Akarozës zbatohet një herë në vit - në muajin nëntor deri në muajin prill dhe nëse ka dyshime në këtë sëmundje, i nënshtrohen të gjitha bletarit e dyshimta në praninë e Akarozës.

Neni 25

Nëse dyshohet se shoqëria e bletëve është e infektuar me këtë sëmundje, hulumtimi diagnostik mund të zbatohet edhe në muajt e tjerë të vitit.

Neni 26

26.1 Në rast se konstatohet prania e sëmundjes së Akarozës në radius prej 3 km, autoriteti kompetent do t'i urdhërojë zbatimin e këtyre masave:

- a) mbylljen e bletores së infektuar,
- b) mjekimin e shoqërive të infektuara me preparatet e regjistruara.

26.2 Ndalohet transferimi i bletëve të infektuara deri sa mos të kalojë periudha e trajtimit.

Neni 27

Konstatohet se Akaroza ka kaluar pasi që të janë ndërmarrë të gjitha masat nga neni 26 i këtij udhëzimi administrativ.

Neni 28

Kompensimi për asgjësimin e shoqërive të bletëve

Bletarëve të cilëve iu janë asgjësuar shoqëritë e bletëve si pasojë e infeksionit me sëmundjet Pesta Amerikane dhe pesta Evropiane autoriteti kompetent me mjetet e siguruar nga Qeveria

e Kosovës do t'ua bëjë kompensimin e tyre sipas procedurave të përcaktuara me Legjislacionin në fuqi.

Neni 29
Zbatimi

29.1 Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, Kryeshefi Ekzekutiv i autoritetit kompetent do të nxjerr vendime si: për shpalljen e bletoreve zyrtarisht të lira nga sëmundjet e përcaktuara në nenin 1 të këtij udhëzimi administrativ, për kompenzime, dhe për çështje të tjera të cekura në këtë udhëzim administrativ.

29.2 Moszbatimi i dispozitave të këtij udhëzimi administrativ do të sanksionohet sipas nenit 45 të Ligjit për Veterinarinë Nr. 2004/21 të dt. 30 Korrik 2004 dhe nenit 45 paragrafi 45.1 pika j) dhe k) të Ligjit Nr.02/L-111 për Bletarinë të dt. 08.02.2008.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë 26.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
